



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 17 Mars 2021

Nr: 154

VENDIM

**PËR MIRATIMIN E LISTAVE SHUMEMËRORE TË PARTISË LËVIZJA E RE PËR
ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 25 PRILL 2021**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 67, 72, pikat 1 e 2, dhe 73, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të udhëzimit nr. 1, datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”, dhe të shkronjës “a”, të pikës 4, të nenit 5, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar, pasi shqyrtova kërkesën e depozituar nga Partia Lëvizja e Re, për miratimin e listave shumëmemërore të kandidatëve për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, dhe relacionin e paraqitur nga Sekretari i Përgjithshëm.

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës, në mbështetje të neneve 65, pikat 1 dhe 2, 92, shkronja “gj”, e 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 8, 9, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, me Dekretin nr. 11700, datë 06.09.2020, ka caktuar datën 25 Prill 2021 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin.

Me vendimin nr. 56, datë 11.02.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Partia Lëvizja e Re është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021.

Në bazë të neneve 67 dhe 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Partia Lëvizja e Re, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dokumentacionin për miratimin e listave shumëmemërore më datë 8.3.2021.



Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me nr. 123, datë 10.03.2021, vendosi kthimin për korrigjimin e dokumentacionit, të listës shumemërore të kandidatëve për deputet të subjektit zgjedhor, Partia Lëvizja e Re.

Brenda afatit ligjor subjekti zgjedhor Partia Lëvizja e Re ridepozitoi dokumentacionin e korrigjuar.

Dokumentacioni i paraqitur përmban:

1. Listat shumemërore për 12 Zonat Zgjedhore; Model - 03
2. Deklaratat e kandidatëve të listave shumemërore, të cilët deklarojnë se gëzojnë të drejtën e votës dhe se pranojnë të kandidojnë si kandidat të listës shumemërore të Partisë Lëvizja e Re; Model – 05;
3. Kopje të dokumentit të identifikimit për të gjithë kandidatët e listave shumemërore;
4. Jetëshkrimin për të gjithë kandidatët e listës shumemërore Model – 07;
5. Vërtetimin nga Kuvendi i Shqipërisë i cili vërteton se Partia Lëvizja e Re ka deputetë të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë;
6. Formularët e vetëdeklarimit për të gjithë kandidatët, në zbatim të ligjit 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.
7. Deklaratën Model 03/1 për disa kandidatë të cilët kanë planifikuar marrjen/ pranimit donacione.

Në mbështetje të nenit 73 të Kodit Zgjedhor, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve verifikoi listat shumemërore të kandidatëve për deputet të Partisë Lëvizja e Re dhe dokumentacionin përkatës ligjor të paraqitur dhe konstatoi se ishte në përputhje me kërkesat e parashikuara nga nenet 67 dhe 72 të Kodit Zgjedhor.

Në përputhje me nenin 5, pika 4, shkronja “a”, të ligjit, nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar, kandidatët për deputet, të subjektit politik Partia Lëvizja e Re, kanë depozituar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i deputetit.

Nga verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit, të kandidatëve për deputetë, rezulton se përveç kandidateve të poshtëpërmendur, të gjithë kandidatët e tjerë nuk kanë deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar.

1. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të **z. Ndue Frrok Shpendaj**, kandidat për deputet, qarku Shkodër, me numër rendor 2, rezulton se ka deklaruar :

Në rubrikën I. “TË DHËNA PERSONALE”, PIKA B, “Gjeneralitete të mëparshme” të formularit të vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar gjeneralitetet e tij dhe është

shprehur se, ka ndryshuar emrin nga “Ndue” në “Nardi” si dhe ka ndryshuar mbiemrin nga “Kolaj” në “Shpendaj”.

Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit,

Pikës 1, “*A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?*” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:

Me vendimin nr. 77 të vitit 2009, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e ka dënuar për veprën penale, “Largim pa leje”, parashikuar nga neni 35/1 I Kodit Penal Ushtarak, për të cilën është vendosur dhe në aplikim të nenit 406 K.Pr.p është caktuar masë dënimi me 10.000 (dhjetë mijë) lekë gjobë.

Pikës 8, *A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?*”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po”, duke deklaruar se:

Ka jetuar në Kajro, Egjipt, për arsye Ekonomike, për periudhën 2011-2014 dhe 2016-2018.

2. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të **z. Viktor Ndue Përleka**, kandidat për deputet, qarku Lezhë, me numër rendor 2, rezulton se ka deklaruar :

Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit:

Pikës 1, “*A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?*” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:

Me vendimin nr. 42 datë 06.02.2003, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mirditë, e ka dënuar për veprën penale, parashikuar nga neni 16/1, I Kodit Penal Ushtarak, për të cilën është vendosur masa e dënimit me 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë me gjobë. Është rehabilituar në bazë të nenit 69 të Kodit Penal.

Pikës 8, *A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?*”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po”, duke deklaruar se:

- Ka jetuar në Angli, Londër, për arsye Emigracioni, për periudhën 2015-2021.
- Ka jetuar në Itali, Venecia, për arsye Emigracioni, për periudhën 1996-2015.

3. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të **z. Denis Petrit Dauti**, kandidat për deputet, qarku Vlorë, me numër rendor 7, rezulton se ka deklaruar :

Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit:



Pikës 1, “A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:

Me vendimin nr. 2019 datë 08.06.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e ka dënuar për veprën penale, “Drejtim i automjetit në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291/1, i Kodit Penal, për të cilën është vendosur masa e dënimit arrest me burg 2 (dy) muaj. Në bazë të nenit 63 të Kodit Penal, pezullohet ekzekutimi i dënimit me burgim në 40 (dyzetë) orë në interes publik.

Pikës 8, A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po”, duke deklaruar se:

- Ka jetuar në Detar, për arsye Pune, për periudhën 2017-2019.

4. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të **z. Ilmi Sali Kuka**, kandidat për deputet, qarku Lezhë, me numër rendor 5, rezulton se ka deklaruar :

Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit:

Pikës 7, “A është marrë ndonjëherë për ju masa e dëbimit nga një shtet i huaj?” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:

Është dëbuar në Greqi, për arsye mungese dokumentacioni për periudhën 2013-2018.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit, nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Kreut V, paragrafi 2, shkronja “b” dhe paragrafi 3, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, me shkresat nr. 1826 prot., datë 09.03.2021 dhe nr. 2079 prot., datë 16.03.2021 (**shkresë e dërguar për shkak të ndryshimit të gjenealiteteve të kandidatëve**) ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 1877 prot., datë 09.03.2021 dhe nr. 2078 prot., datë 16.03.2021 (**shkresë e dërguar për shkak të ndryshimit të gjenealiteteve të kandidatëve**), ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatët për deputet në Kuvendin e Shqipërisë, të subjektit politik Partia Lëvizja e Re, që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresat nr. 2558/1 prot., datë 11.03.2021 dhe nr. 2724/1 prot., datë 16.03.2021 ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatët e për deputet, të subjektit politik Partia Lëvizja e Re, sipas të cilës rezulton se kandidatët për deputet:

1. **Qarku Lezhë, z. Viktor Ndue Përleka, me numër rendor 2**, në bazë të vërtetimit të gjendjes gjyqësore nr. 11 prot., datë 10.03.2021, me vendimin nr. 42 datë 06.02.2003, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mirditë e deklaroi fajtor për veprën penale të “Shmangies nga thirrja për shërbimin ushtarak”, e në bazë të nenit 16/1 të Kodit Penal Ushtarak e dënonte me 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë gjobë.

Rehabilituar në bazë të nenit 69 Kodi Penal.

Referuar deklaramëve të kandidatit për deputet **z. Viktor Ndue Përleka** si dhe përgjigjes së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve vërehet se dënimi me 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë gjobë sipas parashikimeve të nenit 16/1 të Kodit Penal Ushtarak, nuk përfshihet në sferën e ndalimeve të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Referuar të dhënave të disponuara të kandidatit nuk është në kushtet e ndalimit të kandidimit/moszgjedhshmërisë.

2. **Qarku Vlorë, z. Denis Petrit Dauti, me numër rendor 7**, në bazë të vërtetimit të gjendjes gjyqësore nr. 7 prot., datë 10.03.2021, me vendimin nr. 2019 datë 08.06.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e ka deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “Drejtim i automjeteve në mënyrë të parregullt” parashikuar nga neni 291/1 Kodi Penal dhe neni 406 K.Pr.P, duke u dënuar me 2 (dy) muaj burgim.

Në zbatim të nenit 63 të Kodit Penal pezullohet ekzekutimi i dënimit me burgim me 40 (dyzetë) orë pune në interes publik.

Rehabilituar në bazë të nenit 69 të Kodit Penal.

Referuar deklaramëve të kandidatit për deputet **z. Denis Petrit Dauti** si dhe përgjigjes së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve vërehet se dënimi sipas parashikimeve të nenit 291/1 të Kodit Penal, nuk përfshihet në sferën e ndalimeve të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Referuar të dhënave të disponuara të kandidatit nuk është në kushtet e ndalimit të kandidimit/moszgjedhshmërisë.

3. **Qarku Shkodër, z. Ndue Frrok Shpendaj, me numër rendor 2**, në bazë të vërtetimit të gjendjes gjyqësore nr. 17 prot., datë 10.03.2021, me vendimin nr. 77 datë 07.07.2009, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e ka deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “Largim pa leje” parashikuar nga neni 35/1 Kodi Penal Ushtarak dhe neni 406 K.Pr.P, duke u dënuar me 10.000 (dhjetë mijë) lekë gjobë.

Rehabilituar në bazë të nenit 69 të Kodit Penal.



Referuar deklarimeve të kandidatit për deputet **z. Ndue Frrok Shpendaj** si dhe përgjigjes së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve vërehet se dënimi me 10.000 (dhjetë mijë) lekë gjobë sipas parashikimeve të nenit 35/1 të Kodit Penal Ushtarak, nuk përfshihet në sferën e ndalimeve të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Referuar të dhënave të disponuara të kandidatit nuk është në kushtet e ndalimit të kandidimit/moszgjedhshmërisë.

Kandidatët e tjerë të listës shumemërore, të subjektit politik Partia Lëvizja e Re, rezultojnë të jenë të padënuar.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë për verifikimin e të dhënave për kandidatët për deputet, të subjektit politik Partia Lëvizja e Re.

Referuar ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreut V, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, të dhënat e deklaruar në formularin e vetëdeklarimit dhe informacionit të ardhur nga Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve, për kandidatët për deputet, të subjektit politik Partia Lëvizja e Re nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin e kandidatëve, për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 Prill 2021.

Pas verifikimeve përkatëse të kërkesës dhe dokumentacionit në tërësi të listave shumemërore të Partisë Lëvizja e Re, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, konstatoj se dokumentacioni i paraqitur është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 67, 72 dhe 73 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 67, 72, pikat 1 e 2 dhe 73, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në udhëzimin nr. 1, datë 23.12.2020, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”, dhe në shkronjën “a”, të pikës 4, të nenit 5, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar,



V E N D O S :

1. Miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për deputetë, të Partisë Lëvizja e Re, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për zonat zgjedhore, Qarku Berat, Qarku Dibër, Qarku Durrës, Qarku Elbasan, Qarku Fier, Qarku Gjirokastrë, Qarku Korçë, Qarku Kukës, Qarku Lezhë, Qarku Shkodër, Qarku Tiranë dhe Qarku Vlorë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI





Lista shumemërore

Partia Levizja e Re

Qarku Berat

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Majlind	Fuat	Mejdani	30/04/1959	M
2	Tomorr	Refat	Laze	18/01/1967	M
3	Anxhela	Zenel	Toska	10/09/1995	F
4	Aurel	Gurali	Baku	15/12/1997	M
5	Entela	Rudin	Bejdo	03/03/2001	F
6	Vangjel	Theodhor	Buda	09/10/1979	M
7	Vilma	Stavri	Gjika	22/02/1997	F
8	Xhulio	Rustem	Xhindi	24/09/1994	M
9	Era	Artan	Vavla	29/05/2002	F

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 9

Partia Levizja e Re

Qarku Dibër

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Shpëtim	Ali	Puca	07/09/1959	M
2	Elida	Ismet	Elezi	02/11/1997	F
3	Argita	Gëzim	Llani	17/06/1997	F
4	Mevlan	Ramazan	Karaj	01/03/1981	M
5	Xhensila	Hysni	Ndreu	14/01/1997	F
6	Marsika	Fatmir	Metra	23/11/2000	F

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 6



Lista shumemërore

Partia Levizja e Re

Qarku Durrës

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Jonid	Robert	Nano	18/05/1978	M
2	Bledar	Ded	Lleshi	08/05/1984	M
3	Anthusa	Dhimitri	Martiko	30/06/1984	F
4	Florian	Përparim	Kasa	16/07/1984	M
5	Arsen	Isa	Lazri	09/01/1991	M
6	Esmeralda	Sherif	Hysenukaj	17/11/1980	F
7	Ledjan	Kujtim	Hasanaj	29/11/1986	M
8	Eneo	Ylli	Bekteshi	31/08/1998	M
9	Sonila	Qemal	Kikri	03/05/1992	F
10	Ervis	Fatmir	Sina	18/09/1989	M
11	Dorina	Bekim	Veliu	19/06/1997	F
12	Sindi	Fatmir	Gostivari	27/06/2000	F
13	Muharem	Baki	Gega	30/01/1985	M
14	Xheni	Agron	Vogli	29/12/1996	F
15	Edmond	Mino	Xhindi	04/05/1978	M

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 15

Partia Levizja e Re

Qarku Elbasan

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Përparim	Niazi	Demi	10/12/1951	M
2	Ermelinda	Arben	Dervishi	24/04/1997	F
3	Evisa	Andon	Nano	30/04/1983	F
4	Erjada	Lefter	Pëllumbi	20/06/1999	F
5	Anduena	Hydaver	Elezi	11/12/1980	F
6	Elis	Bashkim	Uruçi	07/02/1986	M
7	Julian	Gezim	Demçolli	17/09/1978	M
8	Leonard	Sabri	Doda	31/01/1991	M
9	Fatbardha	Hamdi	Lata	11/06/1996	F
10	Artur	Azis	Arshimi	10/07/1969	M
11	Anisa	Agim	Murataj	26/02/2003	F
12	Katerina	Vasil	Karaj	01/03/1962	F
13	Edon	Përparim	Çela	01/04/1998	M
14	Kozeta	Ibrahim	Muçaj	12/12/1980	F
15	Entela	Astrit	Qato	07/12/1983	F

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 15



Lista shumemërore

Partia Levizja e Re

Qarku Fier

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Denisa	Shkëlqim	Kele	18/07/1986	F
2	Elvira	Gëzim	Elezi	01/11/1986	F
3	Vilson	Bilal	Lulja	18/12/1991	M
4	Klajda	Piro	Koçiu	15/09/1993	F
5	Marsel	Selami	Javori	07/09/1995	M
6	Nertila	Riza	Demiri	21/03/1986	F
7	Igli	Fatos	Delija	13/09/1995	M
8	Sonila	Hajdar	Çela	13/03/1989	F
9	Luçiano	Sadik	Bendo	16/02/1988	M
10	Fjorela	Arben	Myrtaj	04/11/1995	F
11	Renato	Bujar	Bezati	09/08/1990	M
12	Leonora	Mehdi	Zollumi	16/04/2000	F
13	Dean	Edmond	Dhimitri	15/07/1985	M
14	Merita	Përparim	Velaj	08/06/1985	F
15	Ervin	Gjergj	Vuka	04/05/2000	M
16	Danjela	Fran	Gega	27/07/1987	F
17	Erjon	Gjergji	Vuka	18/08/1998	M
18	Sara	Shpëtim	Mersini	09/02/2002	F

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 18

Partia Levizja e Re

Qarku Gjirokastrë

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Altea	Jorgji	Karaj	12/07/1998	F
2	Dorina	Izet	Ahmeti	19/02/1985	F
3	Altin	Sabri	Iljazi	27/01/1972	M
4	Rigest	Kastriot	Lusha	23/02/1985	M
5	Fitime	Selam	Proda	22/07/1988	F
6	Jorgo	Nikolla	Papa	02/09/1995	M

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 6



Lista shumemërore

Partia Levizja e Re

Qarku Korçë

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Ejona	Ali	Mema	16/09/1993	F
2	Rezart	Harif	Laraku	27/01/1989	M
3	Dorina	Medi	Hajdinllari	03/08/1993	F
4	Sandri	Pëllumb	Bajraktari	07/01/1991	M
5	Enea	Arben	Limoni	09/09/1997	M
6	Erjola	Hysen	Manoku	18/10/1982	F
7	Ergison	Dashamir	Basholli	03/07/1992	M
8	Erika	Vangjush	Pere	02/09/2000	F
9	Saimir	Sokol	Mazelli	20/12/1996	M
10	Poliksena	Petrit	Laraku	13/07/2000	F
11	Xhoi	Harif	Laraku	01/06/1999	M
12	Anxhela	Rifan	Guxholli	19/09/1996	F

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 12

Partia Levizja e Re

Qarku Kukës

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Asllan	Xhemali	Hoxha	10/04/1968	M
2	Korab	Hasan	Koka	21/07/1968	M
3	Leonora	Asllan	Shoti	02/11/1998	F

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 3

Partia Levizja e Re

Qarku Lezhë

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Fitimtar	Tom	Lala	10/07/1973	M
2	Viktor	Ndue	Përleka	17/04/1970	M
3	Kristina	Preng	Kasa	24/04/1976	F
4	Rudina	Kadri	Musaraj	15/01/1984	F
5	Ilmi	Sali	Kuka	01/01/1970	M
6	Xhelal	Hazis	Çiku	07/08/1961	M
7	Suzana	Shehadin	Nikshiqi	05/02/1967	F
8	Indrit	Bashkim	Hajdini	04/09/2001	M
9	Manushaqe	Halit	Porja	29/04/1972	F

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 9



Lista shumemërore

Partia Lëvizja e Re

Qarku Shkodër

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Elma	Tahir	Bala	19/07/1963	F
2	Ndue	Frrok	Shpendaj	04/01/1979	F
3	Manjola	Arben	Ndreca	13/06/2001	F
4	Jorgji	Dhimiter	Karaj	28/11/1959	M
5	Arta	Hamdi	Palushi	11/04/1987	F
6	Fabiola	Gjon	Lleshi	20/07/1999	F
7	Mirjan	Nikoll	Bicukaj	02/04/1990	M
8	Olta	Ismet	ELezi	19/02/1995	F
9	Petrit	Liman	Tanushi	07/10/1967	M
10	Arsen	Abaz	Xhediku	01/05/1994	M
11	Zeliko	Memet	Shimi	04/10/1993	F
12	Mir	Njac	Lukani	25/02/1974	M

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 12



Lista shumemërore

Partia Levizja e Re

Qarku Tiranë

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Arian	Pëllumb	Galdini	11/12/1974	M
2	Luljan	Rushit	Strazimiri	20/01/1962	M
3	Dea	Fredi	Bala	01/10/1993	F
4	Gent	Gjergj	Sinani	06/02/1990	M
5	Adriana	Irfan	Laze	22/04/1971	F
6	Elgerta	Nazmi	Kupe	29/06/1991	F
7	Pëllumb	Abaz	Shahini	24/04/1969	M
8	Tea	Leonard	Ndrio	23/06/1996	F
9	Violeta	Refat	Bonaj	05/06/1960	F
10	Mariglen	Fehti	Hoxha	15/10/1996	M
11	Allaman	Isuf	Sula	04/05/1966	M
12	Albana	Avni	Fusha	30/03/1992	F
13	Mersi	Arben	Shehu	23/08/1994	F
14	Marjo	Mentor	Qama	05/04/1989	M
15	Jonida	Mete	Dauti	24/02/1989	F
16	Kejsi	Xhevair	Kërçyku	14/04/2001	F
17	Hilmi	Shahin	Halilaj	21/06/1958	M
18	Florjan	Baftjar	Miraka	22/04/1987	M
19	Anduela	Guxim	Dragoti	15/11/1992	F
20	Amarildo	Kujtim	Merkaj	04/09/1995	M
21	Shpetim	Xheladin	Lala	06/05/1974	M
22	Sara	Shyqo	Hodaj	23/08/1996	F
23	Xhavit	Nebi	Nasufi	05/02/1967	M
24	Irma	Agim	Damjani	18/08/1988	F
25	Leonard	Petrit	Lushi	22/02/1990	M
26	Aurora	Ilmi	Kalemi	16/10/1965	F
27	Melsed	Fiqiri	Dervishaj	18/08/1987	M
28	Fatlinda	Fatmir	Elezi	09/09/1985	F
29	Arsen	Gezim	Demçolli	04/12/1981	M
30	Klaudia	Isa	Çanaku	14/10/1994	F
31	Ërmal	Ilir	Hasanaj	05/11/1985	M
32	Besmir	Murat	Diku	19/11/1994	M
33	Juri	Albert	Gjermani	08/02/1997	F
34	Klonard	Njazi	Plaku	31/07/1986	M
35	Dea	Pëllumb	Shahini	02/10/2001	F
36	Thoma	Vangjel	Papadhimitri	21/04/1954	M

Kjo listë mbyllet me numrin rendor

36



Lista shumemërore

Partia Lëvizja e Re

Qarku Vlorë

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Alban	Reis	Kokallaj	12/04/1970	M
2	Alketa	Mete	Hadëraj	01/06/1995	F
3	Gëzim	Thoma	Mëhilli	08/02/1967	M
4	Kristina	Aleksandri	Nano	24/04/1995	F
5	Enrik	Nazmi	Lato	03/07/1989	M
6	Ërgesa	Temihat	Beqiraj	17/01/1994	F
7	Denis	Petrit	Dauti	09/07/1988	M
8	Anxhelo	Robert	Gjonçi	28/08/1996	M
9	Ana	Selim	Matohiti	04/08/1970	F
10	Gentian	Hilmi	Halilaj	10/09/1987	M
11	Ëlinda	Gëzim	Nushaj	15/12/1995	F
12	Dejvin	Lefter	Hasanaliaj	07/07/1995	M

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 12Subjekti Zgjedhor ka: 153 kandidatë